



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

**Datë: 05.07.2024**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më datë 05.07.2024, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 902, të datës 02.07.2024, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b, c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 30, paragrafi 2, të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), nenin 15, paragrafi 1, nenin 16, paragrafi 11, të Ligjit për Ndarjet Buxhetore për vitin 2024 Nr. 08/L-260, (Gazeta Zyrtare Nr. 26/2023), nenin 27, shkronja (c, ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

#### V E N D I M

#### **Për aprovimin e Propozimit Nr. 902, të datës 02.07.2024 për ri destinimin - transferimin e mjeteve financiare në projekte kapitale për vitin 2024**

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 902, të datës 02.07.2024 për ri destinimin - transferimin e mjeteve financiare të mbetura, si të pa shpenzuara nga projektet kapitale të përfunduara, prej burimit të financimit 22, nga nën - programet e Infrastrukturës Publike 18162, nga pesë projekte kapitale, në projektin kapital të evidentuar në paragrafin Nr. 2 nën - programin e Planifikimit Hapësinorë dhe Rregullativ 66015, të këtij vendimi sipas përshkrimit në vijim:
  - 1.1 Vendosja e ndriçimit publik dhe mirëmbajtja e tyre, kodi i projektit 44697, shuma e mjeteve financiare prej: 28,385.78€;
  - 1.2 Vendosja e kamerave nëpër pikat kryesore të qytetit, kodi i projektit 44715, shuma e mjeteve financiare prej: 24,123.20€;
  - 1.3 Rregullimi i Sheshit në lagjen 'Dardania', kodi i projektit 49363, shuma e mjeteve financiare prej: 48,964.72€;
  - 1.4 Ndërtimi i parqeve, trotuareve, këndeve të lojërave, mbjellja e pemëve dekorative dhe vendosja e shportave, kodi i projektit 52489, shuma e mjeteve financiare prej: 2,471.07€ dhe
  - 1.5 Shenjzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve, pastrimi gjatë sezonit dimëror dhe veror, kodi i projektit 52490, shuma e mjeteve financiare prej: 3,129.18€.
2. Mjetet financiare të evidentuara në paragrafin një, nën paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5, ri destinohen dhe transferohen për shpenzim në nën - programin e Planifikimit Hapësinorë dhe Rregullativ 66015, në projektin kapital: Ndërtimi i kanalizimit dhe ujësjellësit -

fshatra, qytet, kodi i projektit 49732, në shumën e përgjithshme të përmbledhur të mjeteve financiare prej: 107,073.95€.


3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për zbatimin e këtij vendimi për transferimin e mjeteve financiare të evidentuara në pikën një dhe dy të vendimit, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHPM, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së INFST dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**  
**Ali Ismaili**







**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**  
**MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



**Datë: 05.07.2024**

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur të datës 05.07.2024, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1341, të datës 02.07.2024, të paraqitur për shqyrtim nga Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (h), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12.1, shkronja (ë), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (ç, nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**

**Për aprovimin e Propozimit Nr. 1341, të datës 02.07.2024 për lejimin e mjeteve  
financiare dhe hapjen e procedurave për norma - vende të reja të punës në arsim**

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 1341, të datës 02.07.2024, për lejimin e mjeteve financiare në shumën e përgjithshme prej: 159,456.00€ dhe fillimin e hapjes së procedurave për gjashtëdhjetë e gjashtë (66) norma për vende të reja të punës në arsim, për periudhën kohore shtator/dhjetor 2024, të vitit shkollorë 2024/2025, nga granti specifik i arsimit me kod buxhetor Nr. 920, si vijon:
  - 1.1 Për 30 norma të reja për mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm të ulët;
  - 1.2 Për 1 normë për një drejtor shkolle;
  - 1.3 Për 1 normë për një drejtor të institucionit parashkollorë;
  - 1.4 Për 5 norma të reja për mësimdhënës për arsimin e mesëm të lartë;
  - 1.5 Për 10 norma të reja për asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta;
  - 1.6 Për 10 norma të reja për edukatore për para fillorë;
  - 1.7 Për 4 norma të reja për pedagog dhe
  - 1.8 Për 5 norma të reja për psikolog.
2. Shuma e përgjithshme e mjeteve financiare të lejuara nga buxheti i komunës, e cekur në pikën një të vendimit, do të shfrytëzohen për pagesat e gjashtëdhjetë e gjashtë (66) normave të reja për mësimdhënës dhe personel administrativ, për periudhën shtator/dhjetor të vitit shkollorë 2024/2025, sipas specifikacionit dhe llogarisë tabelare të përgatitur nga Drejtoria e Arsimit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi dhe sigurimin e mjeteve financiare nga pika një e këtij vendimi, nga granti specifik i arsimit me kod buxhetor Nr. 920, do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Financave dhe Buxhetit.


4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së ARS, Drejtorisë së FB dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**  
**Ali Ismaili**







REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

**Datë: 01.08.2024**

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 31.07.2024, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 972, të datës 22.07.2024, të paraqitur për shqyrtim nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, të shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (g, s), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (nj), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (e, n), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

#### V E N D I M

**Për aprovimin në parim të Projekt-Dokumenti për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës**

1. Për aprovimin në parim të 'Projekt-Dokumenti për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës' dhe procedimin e saj për diskutim publik.
2. Projekt-Dokumenti për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, i cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e vlerësimit dhe evidentimit të lokacioneve dhe vendeve me rreziqe në territorin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Dokumenti për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimit publik është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.
5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për SHPM dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Ali Ismaili**





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
GRUPTORJA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACION

Nrfaq/Bc.st. 103  
Data/Datim. 02.08.2024



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



**Datë: 01.08.2024**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.07.2024, pas shqyrtimit të Kërkesës Nr. 02-070/05-0021913/24, të datës 17.08.2024, të paraqitur nga Sindikata e Administratës së Komunës së Fushë-Kosovës e shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (ç) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**

**Për financimin e shujtave ditore për nëpunësit e Shërbimit Civil të Administratës të Komunës së Fushë-Kosovës**

1. Për aprovimin e Kërkesës Nr. Nr. 02-070/05-0021913/24, të datës 17.08.2024, për realizimin e shujtave ditore për nëpunësit e shërbimit civil të Administratës së Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Shuma e mjeteve financiare të ndara sipas pikës një të këtij vendimi, është 4 € në ditë, për secilin nëpunës të shërbimit civil të Administratës Komunale, e siguruar nga kategoria e “Paga dhe shtesa”.
3. Qëllimi i këtij vendimi është realizimi i shujtave ditore, në vlerë prej 4 € në ditë, në mënyrë retroaktive, për vitin 2023 dhe për vitin 2024 për të gjithë nëpunësit e shërbimit civil të Administratës Komunale në Fushë-Kosovë.
4. Për kryerjen dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, kujdesen dhe është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorive tjera Komunale.
5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorive tjera Komunale dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Ali Ismaili**

